

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Vushtrri – Raporti komunal

Tetor 2009

Vushtrri në shifra

Popullsia	Gjithsej	83,064
	Shqiptarë	95%
	Rom	5%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	344
	Numri i fshatrave	67
Shkollimi	Pa shkollë/ fillore e papërfunduar	10.21%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	33.26%
	E mesme	49.10%
	Shkollë e lartë	6.38%
	Universitet	1.06%
	Nr. i nxënësve	17,800
	Nr. i mësimdhënësve	872
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	3
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	47
	Nr. i çerdheve	1
Shëndetësia	Spital	1
	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	12
	Nr. i mjekëve	40
Papunësia	Gjithsej	42.95%
	Meshkuj	39.32%
	Femra	53.23%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	50,669
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,548
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	8,110,857
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	560,000
	Të hyrat tjera (Euro)	7,550,857
Shpenzimet e realizuara (2008) ¹	Gjithsej (Euro)	7,152,082 (92%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	1,715,339 (80%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	5,436,743 (83%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	38.66%
	LDK	22.92%
	AKR	10.55%
	Iniciativa Qytetare e Bashkimit Demokratik	6.76%
	AAK	5.66%
	LDD	5.34%
	PD	3.62%
	ORA	3.09%
Tjera	3.37%	
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Muharrem Shabani (LDK) 2002-2007: Muharrem Shabani (LDK) 2007-2009: Bajram Mulaku (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Vushtrinë

Vushtrria, dikur e njohur si Vicianum, është një nga vendbanimet më të vjetra në Kosovë. Në këtë qytet ka shumë objekte të vjetra siç janë Ura e Vjetër e Gurit, Kalaja e Qytetit dhe Hamami i Qytetit. Por përveç këtyre objekteve që janë në gjendje jo të mirë, nuk ka mbetur asgjë më shumë nga qyteti i lashtë Vicianum. Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriore të Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 344 km². Ka një popullatë prej 83,064 banorë, ku 95% e tyre janë shqiptarë, kurse 5% janë të tjerë, kryesisht romë. Përgjatë kësaj komune kalon njëri nga lumenjtë më të mëdhenj, Sitnica. Ekonomikisht Vushtrria nuk është e zhvilluar edhe aq shumë. Pothuajse të gjitha komunat e Kosovës përballen me probleme të mungesës së ujit të pijes, mirëpo ky problem është shumë më i theksuar në Komunën e Vushtrrisë.

Problemet aktuale

Qytetarët e Komunës së Vushtrrisë përballen me probleme të shumta, siç janë papunësia, varfëria, zhvillimi i ulët ekonomik, mungesa e ujit të pijes, etj. 42.9% e popullsisë së aftë për punë nuk mund të sigurojnë një vend pune. 17,165 qytetarë janë të regjistruar si punëkërkuar në Qendrën Komunale të Punësimit në Vushtrri (20.6% e popullsisë). Mirëpo numri i të regjistruarve për punë nuk paraqet numrin real të papunësisë, ngase shumë punëkërkuar nuk regjistrohen në Qendrën Komunale të Punësimit. 2,058 familje me 9,762 anëtarë janë të varur nga ndihmat sociale (11,75% e popullsisë). Përveç këtyre problemeve jetike, qytetarët e kësaj komune përballen edhe me problemet si:

- Mungesa e ujit,
- Mbeturinat dhe ndotja e ambientit,
- Rrugët e ngushta dhe mungesa e trotuareve ,
- Mungesa e urës në fshatin Prelluzhë,
- Mungesa e përkujdesjes ndaj trashëgimisë kulturore.

Për qytetarët e komunës së Vushtrrisë, **mungesa e ujit** konsiderohet një ndër problemet më të mëdha dhe me të ndjeshme. Ky problem daton që nga periudha e pasluftës, dhe asnjë qeveri komunale deri më tani nuk ka bërë mjaft në këtë drejtim. Kohëzgjatja e reduktimeve të ujit është tepër e gjatë, shumica e familjeve kanë ujë vetëm 4 orë në ditë. Kjo gjendje është e njëjtë si për qendrën urbane, ashtu edhe për fshatrat.

Mbeturinat dhe ndotja e ambientit. Mbeturinat dhe ndotja e ambientit janë probleme që shqetësojnë gjithnjë e më shumë qytetarët e kësaj komune. Kemikalet që lirohen nga qymyri që përdoret nga KEK-u derdhen në lumin Sitnica, i cili pastaj kundërmon dhe paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve të cilët vinë në kontakt me ujin e ndotur të këtij lumi. Përveç ndotjes së lumit, në Komunën e Vushtrrisë hasen edhe deponi të shumta bërlloku. Ura e Gurit, një nga objektet më të vjetra të qytetit, tani është shndërruar në vend për hedhjen e mbeturinave. Në shumë hapësira në qytet dhe nëpër fshatra mungojnë kontejnerët, kurse në ato vende që ekzistojnë kontejnerët ata nuk mirëmbahen me rregull nga kompania regjionale për grumbullimin e mbeturinave. Edhe parku i qytetit, i cili ishte ndërtuar para disa viteve nga një donacion i huaj, tani është i mbushur me mbeturina dhe nuk mirëmbahet si duhet. Qytetarët e kësaj komune nuk kanë një park të mirëmbajtur ku

do të mund të kalonin kohën. Në përgjithësi mungojnë hapësirat e gjelbëruara në qytet.

Rrugët e ngushta në qytet dhe mungesa e trotuareve. Qyteti i Vushtrrisë është njëri nga qytetet me rrugët më të ngushta në Kosovë. Qyteti nuk ka një shesh dhe rrugët që shpiten në qendër të qytetit apo anasjelltas janë shumë të ngushta. Ndërtimet e shumta që nga pas lufta nuk kanë lënë hapësirë as për ndërtim të trotuareve për këmbësorë. Automjetet kanë vështirësi qarkullimi në qytet, kurse në mungesë të shtigjeve për këmbësorë qytetarët detyrohen që të ecin përskaj rrugës kryesore. Këtë situatë e rëndon edhe më shumë mungesa e hapësirave për parkingje. Dikur një qytet i vjetër, tani në qendrën e Vushtrrisë janë ndërtuar objekte shumë katëshe të cilat i kanë zënë frymën qytetit. Para disa viteve, në kundërshtim me qëndrimet e qytetarëve, AKM ka privatizuar një pronë në qendër të qytetit, përballë objektit të komunës. Në atë hapësirë është ndërtuar një objekt shumë katësh dhe me gjerësi të madhe. Ndërtimi i këtij objekti ka bërë që komuna të humb edhe mundësinë e fundit që të ketë një shesh në qendër të qytetit.

Mungesa e urës në fshatin Prelluzhë. Banorët e Prelluzhës nuk kanë lejuar autoritetet komunale që të ndërtojnë urën mbi lumin Sitnica me arsyetimin se kjo urë do tua rrezikonte sigurinë e tyre për shkak se komunikacioni do të rritej ndjeshëm. Prelluzha është e banuar me shumicë serbe, dhe mos ndërtimi i urës në këtë fshat ka marrë edhe konotacione politike. Në mungesë të kësaj ure, banorët e fshatrave Zhilivodë, Strovçë, Bivoluk, Gllavotin dhe Bequk nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë. Banorët e këtyre fshatrave detyrohen që të udhëtojnë 20 km më shumë në rast se ata dëshirojnë që të shkojnë në Prishtinë. Atyre u duhet që së pari të drejtohen për në qytetin e Vushtrrisë, prej nga lidhen në rrugën magjistrale për Prishtinë.

Mungesa e përkujdesjes ndaj trashëgimisë kulturore. Në qendër të qytetit të Vushtrrisë ndodhen tri monumente me rëndësi historike: Ura e Gurit, Hamami dhe Kalaja. Në asnjërin prej këtyre objekteve nuk është investuar asgjë në mirëmbajtjen dhe konservimin e tyre. Kalaja në qendër të qytetit është shndërruar në vend për hedhjen e mbeturinave. Edhe objektet tjera historike nuk janë në gjendje më të mirë. Ura e Gurit është përvetësuar edhe si simbol në stemën zyrtare të komunës. Mirëpo ky objekt është jashtë përkujdesjes institucionale. Para dy viteve, komuna kishte bërë rrethimin e këtij objekti dhe kishte plane për renovimin e urës. Mirëpo më pas kjo iniciativë është ndërpre. Sipas Pakos së Ahtisarit, Ura e Gurit emërtohet si “Ura e Vojniviçve” dhe cilësohet si objekt historik serb. Klasifikim i këtillë ka ngjallur reagime dhe debat rreth historikut të këtij objekti.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Për shtatë vitet me radhë (2002-2007) Komuna e Vushtrrisë është qeverisur nga LDK. Kryetar i komunës për këto shtatë vite ishte Muharrem Shabani. Zgjedhjet e vitit 2007 i fitoi PDK dhe Bajram Mulaku, kandidat i kësaj partie për kryetar komune. Në raundin e parë të zgjedhjeve, Bajram Mulaku fitoi 34.7% të votave duke shkuar kështu në balotazh me kandidatin Muharrem Shabani, i cili këto zgjedhje ishte pjesë e Iniciativës Qytetare Bashkimi Demokratik. Në raundin e dytë Bajram Mulaku fitoi 57.5% të votave.

Premtimet para zgjedhore të dhëna në fushatën e 2007 kishin të bënin me zgjidhjen e problemit të ujit, ndërprerjen e ndërtimeve të egra, ngritjen e disiplinës në administratë, hartimi i planit urbanistik të qytetit, përkujdesje ndaj objekteve kulturore-historike, asfaltim të rrugëve, etj.

Dy vite pas zgjedhjeve të 2007, edhe më tutje qytetarët përballen me shumë probleme. Një nga këto probleme është mungesa e ujit të pijes. Komuna ende nuk e ka miratuar planin urbanistik të qytetit dhe nuk dihet se miratimi i këtij plani a do të mund të zgjidh gjendjen jo të mirë në komunikacion rrugor në qytet dhe hapësirat e ngushta për kalim të automjeteve dhe këmbësorëve. Tri objektet historike në qytet edhe më tutje mbetet pa përkujdesje institucionale. Në administratën e Vushtrrisë mungon rregullli dhe disiplina në punë. Por, gjatë këtyre dy viteve është bërë mjaft në asfaltimin e rrugëve.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Zgjidhja e problemit të ujit brenda mandatit.	Mungesa e ujit të pijes edhe më tutje është një nga problemet më të mëdha të kësaj komune dhe për këto dy vite ky problem nuk është lehtësuar.
Ndërprerja e ndërtimeve të egra dhe ruajtja e tokës bujqësore.	Gjatë 2008 dhe 2009, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë në shumë mbledhje të tij ka marrë vendime për kthimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, sidomos në aksin rrugor Prishtinë-Mitrovicë.
Ngritja e rregullit, disiplinës dhe punës në administratë.	Qytetarët ankohen se në Komunën e Vushtrrisë ka radhë të gjata për pritje me rastin e marrjes së dokumenteve, zyrtarët komunal ndodh që të mos jenë në vendet e tyre të punës.
Hartimi i planit urbanistik të qytetit.	Plani urbanistik i qytetit ende nuk është miratuar në Kuvend Komunal.
Shtrimi me asfalt i të gjitha rrugëve të fshatrave, në përjashtim të fshatit Skromi i cili ndodhet shumë larg nga qendra urbane.	Gjatë këtyre dy viteve është bërë mjaft në asfaltimin e rrugëve. Që nga pas lufta janë shtruar rrugë në të gjitha lokalitetet e komunës.
Hartimi i projekteve ideore për ruajtjen dhe konservimin e "Urës së Gurit", Kalasë dhe hamamit. Këto tri projekte do të qiten në koncesion.	Objektet historike ndodhen jashtë përkujdesjes institucionale dhe janë në gjendje jo të mirë.
Mundësi të barabarta për të dy gjinitë.	Në administratën komunale të Vushtrrisë janë të punësuar 209 qytetarë. Prej tyre vetëm 41 apo 19.6% janë femra.

Zgjedhjet lokale në Vushtrri

Në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë mund të zënë vend 31 përfaqësues. Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale, 28 subjekte politike kanë garuar për të siguruar vend në KK, por vetëm tetë prej tyre kanë arrit që të përfaqësohen në njërën nga legjislaturat. Vetëm tri parti politike janë përfaqësuar në të tri mandatet. Në zgjedhjet e para të vitit 2000, partitë më të mëdha në këtë komunë dolën të jenë LDK dhe PDK. Në zgjedhjet e 2000, LDK mori 16,652 vota apo 20 ulëse në KK, PDK mori 7,154 vota apo 9 ulëse në KK, ndërsa partia e tretë më e madhe ishte AAK me 2 ulëse. Kryetar i Komunës në mandatin e parë ishte Muharrem Shabani. Dy vite më vonë më 2002, LDK arriti t'i fitoj zgjedhjet përsëri duke i siguruar Muharrem Shabanit edhe një mandat tjetër, kësaj radhe katër vjeçar (por që u bë mandat pesëvjeçar pasi që zgjedhjet lokale u shtynë për një vit). LDK në këto zgjedhje mori 14,538 vota karshi PDK e cila mori 8029 vota. Nga 31 ulëse të KK, LDK siguroi 18, PDK 10, kurse 2 ulëse AAK. Zgjedhjet e treta me radhë ato të vitit 2007 sollën një skenar tjetër. Këto zgjedhje i fitoi PDK, e cila siguroi 13 ulëse, LDK u radhit e dyta me 7 ulëse në KK; AAK edhe në këtë mandat e mbajti numrin e njëjtë të ulëseve.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Vushtrrisë.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	7154	9	8029	10	7765	13
LDK	16652	20	14538	18	-	7
AAK	1366	2	1362	2	-	2
LDD	-	-	-	-	-	2
AKR	-	-	-	-	-	3
Iniciativa Qytetare e Bashkimit Demokratik	-	-	-	-	-	2
ORA	-	-	-	-	-	1
PD	-	-	418	1	-	1

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 76%, dy vjet më vonë ajo ra në 52.5%. Në vitin 2007 pjesëmarrja në votime kishte rënë dukshëm, ku vetëm 20,084 kishin dal në zgjedhje, që është shumë më pak se në zgjedhjet e vitit 2000 dhe 2002. Sikurse në çdo komunë tjetër, edhe në komunën e Vushtrrisë në tri palë zgjedhjet e kaluara numri i votuesve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, kurse pjesëmarrja në votime ka shkuar duke rënë. Në zgjedhjet e 15 Nëntorit 2009 të drejtë vote kanë 60,779 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Vushtrri në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	36291	49264	?	60779
Pjesëmarrja në votime	27581	25873	20084	-
Përqindja e daljes në votime	76.0%	52.5%	?%	-

Buxheti i Komunës

Buxheti i komunës së Vushtrrisë për vitin 2009 është 8,110,857 euro, që njëherit është edhe buxheti më i lartë që ka pas kjo komunë që nga vitit 2003. Po të krahasohet me buxhetin e vitit 2008 që ishte 6,131,164 euro, Vushtrria për vitin 2009 ka një buxhet më të madh për afër 2 milion euro. Rritja e buxhetit për 2009 shënoi edhe rritje të shumës për investime kapitale, që këtë vit kap shumën prej 2,218,648 euro. Kjo është shuma më e lartë e shpenzuar për investime kapitale. Në përgjithësi, Komuna e Vushtrrisë ka pas një buxhet mesatarisht prej 5 milion euro gjatë gjashtë viteve të kaluara. Përndryshe, buxheti i Komunës së Vushtrrisë është dyfishuar brenda gjashtë viteve.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€4,672,929	€937,702	€201,578	€80,000	€2,218,648	€8,110,857
2008	€3,970,644	€1,036,891	€191,978	€80,000	€851,651	€6,131,164
2007	€3,785,099	€720,655	€169,211	€80,000	€709,504	€5,464,469
2006	€3,755,552	€757,670	€171,929	€81,964	€941,041	€5,708,156
2005	€3,636,644	€642,110	€123,992	€41,511	€845,505	€5,289,762
2004	€3,380,627	€993,830			€1,376,256	€5,768,313
2003	€2,789,078	€1,200,897			€907,792	€4,917,556

Nga tabela e mësipërme mund të shohim se ka pas një rritje të shpenzimeve edhe për rroga dhe mëditje. Në fakt pjesa më e madhe e buxhetit të vitit 2009 është e orientuar për rroga dhe mëditje, gjithsej 4,672,929 euro. Komuna e Vushtrrisë, buxhetin e 2008 ka arrit ta shpenzoj në masën 92%. Kurse në periudhën janar-qershor, buxheti i 2009 është shpenzuar në masën 38.3%.

Sa i përket të hyrave vetaneke, në vitin 2008 Komuna e Vushtrrisë ka qenë njëra ndër pesë komunat më të suksesshme në arkëtimin e të hyrave konform planit buxhetor. Në vitin 2008, komuna ka arrit që të arkëtoj 831,000 euro, apo 145.8% në mjeteve të planifikuara në fillim të vitit.

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Komunës së Vushtrrisë për 2010-2012, për tri vitet në vazhdim buxheti i përgjithshëm i komunës do të jetë 25,553,816 euro (Shih tabelën 6).

Investimet kapitale

Nga buxheti i përgjithshëm, Komuna e Vushtrrisë për vitin 2009 ka ndarë 2,218,648 euro për investime kapitale. Për dy vite (2008 dhe 2009), kjo komunë ka ndarë rreth mbi 3 milion euro për investime kapitale. Në tabelën e më poshtme mund të shihni disa nga projektet e financuara nga ky buxhet.

Tab.5.: Investimet kapitale në Vushtri gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Pantinë-Ashlan	€159,585
2008	Asfaltimi i rrugës Samadrexhë-Ceceli-Sllakoc	€175,322
2008	Asfaltimi i rrugës Bivolak-Zhilivod	€128,818
2008	Asfaltimi i rrugës Vermicë-Reznik-Shallc	€127,215
2008	Ndërtimi, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës kryesore në qendër të qytetit	€200,000
2008	Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena	€200,000
2009	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Smrekonicë	€126,000
2009	Asfaltimi i rrugës së fshatit Mihaliq-te shkolla	€67,677
2009	Asfaltimi i rrugës Vermicë-Kollë	€100,000

Në vitin 2008, buxheti i ndarë për investime kapitale ka arrit të shpenzohet në masën 80%. Pjesa më e madhe e këtij buxheti është shpenzuar në tre mujorin e fundit, pasi që deri në fund të shtatorit 2008 ishte shpenzuar vetëm 41% e buxhetit.

Kuvendi Komunal i Vushtrrisë ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, kjo komunë do të ketë në dispozicion 7,387,545 euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Vushtrrisë 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	8,919,609	8,168,186	8,466,021
Të hyrat vetanake në €	868,719	273,497	281,387
Investimet kapitale në €	2,619,495	2,247,857	2,520,193

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Vushtrrisë për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion afër 10 milion euro për investime kapitale

Administrata komunale

Në komunën e Vushtrrisë të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 1,548. Krahasuar me vitin 2008, numri i punonjësve është zvogëluar për 11 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 620 banorë duhet të ketë një punëtorë administrativ, del se komuna e Vushtrrisë mund të ketë deri 176 punëtorë administrativ. Momentalisht, kjo komunë ka të punësuar 170 punonjës në administratën komunale. Në administratën komunale të Vushtrrisë janë të punësuar 209 punonjës. Në strukturën gjinore të nëpunësve të administratës bie në sy numri i

ulët i pjesëtarëve të gjinisë femërore ku janë të punësuar vetëm 41 femra apo 19.6%. Nga 41 femrat punonjëse në administratë, vetëm pesë prej tyre kanë shkollim superior, 25 kanë shkollim të mesëm dhe 5 shkollim fillor. Në përgjithësi nga 209 të punësuarit, vetëm 40 kanë shkollim superior.

E tërë administrata komunale është e përqendruar në një objekt të vetëm. Ky objekt nuk i plotëson kushtet për punë efektive dhe pritje të palëve pasi që objekti është i vjetër dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme. Qytetarët ankohen për mungesë të rregullit në administratë dhe radhë të gjata pritjesh.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Vushtrrisë sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1548
2008	1557 ▲
2007	1549
2006	1661 ▲
2005	1568
2004	1654 ▲
2003	1593 ■

Komuna e Vushtrrisë dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, e që duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK e Vushtrrisë gjatë vitit 2008 ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009 ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta, numër ky që është konform nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 11 herë, kurse në gjashtëmuorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës.

Sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, gjatë vitit 2008 Kryetari i Komunës ka mbajtur tri tubime, kurse për gjashtëmuorin e parë të vitit 2009 është mbajtur vetëm një. Komuna gjatë vitit 2008 ka pranuar një peticion.

Komuna e Vushtrrisë ka edhe uebfaqen e saj zyrtare. Uebfaqja ka mungesa të konsiderueshme informacionesh të cilat do t'i nevojiteshin çdo qytetari rreth aktiviteteve të komunës siç janë, për shembull shërbimet komunale, të cilat mungojnë në tërësi, mandej në përgjithësi ueb faqja ka mangësi si në strukturën organizative ashtu edhe në mbajtje të të dhënave në ueb faqe.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë (www.kk-vushtrri.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	3
Organizimi komunal	4
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	2.25
Projektet komunale	1.5
Lajme& lajmërimë	1
Harta e faqes	1
Kontakt	2
Gjuhët	3
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	2.15
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	25

Gjendja në arsim

Arsimi në Komunën e Vushtrrisë zhvillohet në tri nivele, atë parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në këtë komunë ekziston një çerdhe për fëmijë, 'Foleja' si dhe shtatë institucione tjera që janë në kuadër të shkollave fillore. Komuna e Vushtrrisë ka gjithsej 47 shkolla fillore, ku dy prej tyre zhvillojnë mësimet në gjuhën serbe. Numri i nxënësve në shkollat fillore shqipe është 14,013 nxënës, kurse në shkollat serbe mësojnë 357 nxënës. Kjo komunë ka edhe tri shkolla të mesme me gjithsej 3,874 nxënës. Numri i mësimdhënësve është 872. Përndryshe kjo komunë ka 1.4 punonjës arsimor për 100 banorë, që është përafërsisht e njëjtë me komunat tjera.

Gjendja në shëndetësi

Në komunën e Vushtrrisë ofrohet vetëm mjekësia primare. Kjo komunë ka një spital të quajtur 'Sheikh Zajed', i cili u shërben nevojave të vushtrriasve por edhe më gjerë. Funkcionon një QKMF, shtatë QMF dhe pesë ambulanca në lokalitete të ndryshme. Numri i mjekëve në këtë komunë është 40, kurse numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësor është 173, apo 2.5 punëtorë shëndetësor për 1,000 banorë.

Shoqëria civile

Në komunën e Vushtrrisë ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i OJQ-ve. Sipas disa të dhënave numri i OJQ-ve arrin në 60. Mirëpo, shumë pak nga këto organizata janë aktive. Fokusi kryesor i organizatave aktive është rinia, fuqizimi i gruas në shoqëri dhe avancimi i të drejtave të personave të hendikepuar. Nuk ka organizata të cilat monitorojnë punën e organeve komunale, përveç përfaqësuesit të HENDIKOS i cili është më aktiv në këtë drejtim.

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Mediat lokale

Gazetat ditore nuk kanë korrespondent të rregullt për Vushtrri, përveç “Zëri”-t gazetar i cili njëherësh është edhe zyrtar për informim në komunë. Në këtë komunë ekziston vetëm një radio lokale, Radio “Vicianum” drejtori i së cilës mban postin edhe të Drejtorit të Kulturës në kuadër të administratës komunale.

Rendi dhe ligji në Komunën e Vushtrrisë

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Vushtrrisë, kanë ndodhur 2412 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 65 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Vushtrri (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	155
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	186
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	17
Vjedhje e pyjeve	16
Incidente lidhur me pronën	71
Vjedhje	551
Abuzime seksuale	6
Shkaktim të dëmtimeve trupore	76
Kërcënime	49
Mashtrime	17
Vrasje	7
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Gjatë vitit 2008, në komunën e Vushtrrisë kanë ndodhur gjithsej 186 raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, duke e rëndit kështu Vushtrrinë në vendin e gjashtë për nga numri i madh i rasteve të tilla. Edhe numri i vjedhjeve gjatë vitit 2008 ka qenë relativisht i madh, ku janë shënuar 551 raste. Në vitin e kaluar janë shënuar 7 raste të vrasjeve, por asnjë incident në bazë të dallimeve etnike apo fetare.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë ka miratuar Rregulloren komunale për tatim në pronë. Sipas kësaj rregulloreje, tatimi në pronë në Komunën e Vushtrrisë përlogaritet në bazë të katër zonave dhe normat tatimore sillen nga 0.09% deri 0.13%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Vushtrrisë

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.09%	0.09%	0.13%	0.11%	0.09%
I	500 €	400 €	1,200 €	250 €	150 €
II	450 €	350 €	1,000 €	200 €	150 €
III	400 €	300 €	800 €	150 €	100 €
IV	350 €	250 €	600 €	100 €	60 €

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në këtë komunë janë të regjistruara 1,052 biznese private të llojeve të ndryshme. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale e Vushtrrisë. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumatat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab 11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	480 €
Kompanitë e sigurimit	240 €
KEK	800 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	800 €
Barnatoret	200 €
Agjensionet turistike	160 €
Hotelet	320 €
Motelet	240 €
Supermarketet - Hipermarketet	400 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	240 €
Kafeteritë	120 €
Restorant	200 €
Autoshkollat	120 €
Gurthyesit	640 €
Rrjeti kabllorik me internet	800 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthëtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	60 - 192 €
Depot	192 €
Pompat e benzinës	480 €
Ndërmarrjet ndërtimore	160 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	120 - 200 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.